



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria – Vlada – Government*  
**Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit / Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta /**  
**Ministry of Culture, Youth and Sport**

---

**17.01.2023, Prishtinë**

**Thirrje për aplikim**

Bazuar në Thirrjen publike “Konsultimi i të Mbijetuarve dhe Familjeve me Fëmijë të Vrarë gjatë Luftës 1998-1999 në Kosovë”, në përputhje me Nenin 8, paragrafin 3.2 të Rregullores së Ministrisë së Financave Nr. 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, ftojmë organizatat jo qeveritare/shoqërinë civile/njohësit e kulturës, të aplikojnë për të marr pjesë në komisionin e vlerësimit, në cilësinë:

*- përfaqësues nga OJQ-të*

*- përfaqësues në cilësinë e njohësit të fushave përkatëse*

Të drejtë aplikimi kanë:

1. Të punësuarit në organizatat jo-qeveritare aktive në Republikën e Kosovës;
2. Njohësit e fushave **histori dhe trashëgimi kulturore**.

Kandidatët duhet të plotësojnë këto kushte:

- Duhet të kenë të kryer së paku nivelin e studimeve Bachelor;
- Të kenë përvojë në projektet e OJQ-ve;
- Të mos jenë të emëruar politik, shërbyes civil apo pozita të ngjashme në administratën shtetërore.

Kandidatët duhet të dorëzojnë këto dokumente:

- Një CV;
- Dëshmi për shkollimin dhe përvojën e punës;
- Përfaqësuesi nga OJQ duhet të dorëzojnë një letër nominimi nga Udhëheqësi i OJQ-së në të cilën dëshmohet se aplikuesi është i punësuar apo i angazhuar në organizatë.

Përfaqësuesit e lartpërmendur do të jenë anëtarë të Komisionit vlerësues për vlerësimin e projekt-propozimeve për projektin në fushën e trashëgimisë kulturore “Konsultimi i të Mbijetuarve dhe Familjeve me Fëmijë të Vrarë gjatë Luftës 1998-1999 në Kosovë”, të pranuar nga organizatat jo qeveritare (OJQ) sipas thirrjes publike të datës: 06.01.2023.

Aplikimi mund të bëhet përmes e-mail: [milot.mustafa@rks-gov.net](mailto:milot.mustafa@rks-gov.net) dhe [merita.augustini@rks-gov.net](mailto:merita.augustini@rks-gov.net) deri me datën 23.01.2023, dhe të shkruhet **qartë për pozitën për anëtar të komisionit për të cilën aplikoni.**

Anëtarët e jashtëm të cilët përzgjedhën për komisionin vlerësues: *një përfaqësues nga OJQ-të dhe një përfaqësues në cilësinë e njohësit të fushave përkatëse*, do të kompensohen për punën e tyre me pagesë neto 200.00 €.

MKRS-ja do të vlerësojë të gjitha aplikacionet e pranuar dhe do të përzgjedhë nga një kandidatë, që do të jenë pjesë e Komisionit Vlerësues të thirrjes publike të datës 06.01.2023 të publikuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.